



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITR

02 Nr. / Br 1458/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 07.12.2023

VUSHTRRI - VUČITR



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE NË ARSIMIN PUBLIK

1. Themelohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare të Arsimit publik në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 Enver Bajrami, kryesues
 - 1.2 Musaj Tërbunja, anëtar
 - 1.3 Hashim Hajrizi, anëtar
2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike të arsimit të komunës, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht Rregullën për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014.
3. Komisioni gjatë punës së tij do të ketë parasyshtë si në vijim:
 - 3.1 Bazë kryesore e inventarizimit për vitin fiskal 2023 duhet të jetë regjistri elektronik i inventarit i gjeneruar nga sistemi E/pasuria.
 - 3.2 Komisioni obligohet të harmonizojë regjistrin e deritashëm elektronik të mbajtur në excel me regjistrin elektronik të inventarit në E/pasuria, dhe të përpilojë një regjistër unik konform të dhënave që i kërkon E/pasuria.
 - 3.3 Komisioni obligohet gjithashtu që të dhënat në regjistrin e harmonizuar nga të dy listat t'i verifikojë në terren me rastin e regjistrimit të inventarit.
 - 3.4 Komisioni obligohet që gjatë verifikimit fizik të pasurisë të:
 - 3.4.1 identifikojë pasurinë që mungon në të dy regjistrat elektronik
 - 3.4.2 identifikojë pasurinë e dëmtuar dhe që është jashtë përdorimit.
4. Komisioni obligohet që para se të fillojë verifikimin fizik në terren të bashkëpunojë me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e depos në nxjerrjen e informatave të përditësuara nga regjistri E/pasuria dhe regjistri alternativ i të dhënave (excel) për çka obligohen për harmonizim.

5. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe përfundoj regjistrimin e inventarit deri në fund të muajit dhjetor 2023.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për Arsim
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr./ Br 1491/23

Nr. i fq./ Bc. st _____

Data: / Datum: 11.12.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorisë për Administratë datë 08.12.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE NË ADMINISTRATËN E KOMUNËS

1. Themelohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare në Administratën e Komunës, në këtë përbërje:
 - 1.1 Rexhep Gërguri, kryesues i komisionit
 - 1.2 Shqipe Xhema, anëtare
 - 1.3 Fitim Klinaku, anëtar
2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të kryej inventarizimin në institucionet publike të shëndetësisë, në pajtim me Rregulloren e MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht Rregullën për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014.
3. Komisioni gjatë punës së tij do të ketë parasyshë si në vijim:

Bazë kryesore e inventarizimit për vitin fiskal 2023 duhet të jetë regjistri elektronik i inventarit i gjeneruar nga sistemi E/pasuria.

 - 3.1 Komisioni obligohet të harmonizojë regjistrin e deritashëm elektronik të mbajtur në excel me regjistrin elektronik të inventarit në E/pasuria, dhe të përpilojë një regjistër unik konform të dhënave që i kërkon E/pasuria.
 - 3.2 Komisioni obligohet gjithashtu që të dhënat në regjistrin e harmonizuar nga të dy listat t'i verifikojë në terren me rastin e regjistrimit të inventarit.
 - 3.3 Komisioni obligohet që gjatë verifikimit fizik të pasurisë të:
 - 3.3.1 identifikojë pasurinë që mungon në të dy regjistrat elektronik
 - 3.3.2 identifikojë pasurinë e dëmtuar dhe që është jashtë përdorimit.
4. Komisioni obligohet që para se të fillojë verifikimin fizik në terren të bashkëpunojë me zyrtarin e pasurisë dhe zyrtarin e depos në nxjerrjen e informatave të përditësuara nga

regjistri E/pasuria dhe regjistri alternativ i të dhënave (excel) për çka obligohen për harmonizim.

5. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe përfundoj regjistrimin e inventarit deri në fund të muajit dhjetor 2023.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për Administratë
- Drejtorit për Buxhet dhe Financa
- Zyrtarit të pasurisë
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br. 1552/23

Nr. i fq. / Br. st. _____

Data: / Datum: 20.12.2023

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në kërkesë të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport datë 18.12.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT VLERËSUES

1. Themelohet komisioni vlerësues për vlerësim të aplikacioneve për nëngrante për ciklin e dytë të projektit “Komuna për të Rinjtë” në Vushtrri.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 2.1 Besmir Ahmeti
 - 2.2 Redona Vatovci
 - 2.3 Shkëlqim Behrami
 - 2.4 Blerim Ibrahim
 - 2.5 Fatmir Haradinaj
3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi ka për detyrë të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të nënprojektit, projekti “Komunat për të Rinjtë – M4Y” dhe shpall përfituesit e projektit.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02Nr. 1269/23, datë 27.10.2023.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- Arkivit të Sekretarisë.